



Lënda e Taksimit në librin **Taksimi Normativ** trajton detyrimet tatimore kombëtare dhe vendore, si dhe detyrimet doganore duke trajtuar tiparet për përbëjnë identitetin e tatimit. Në këtë nivel studenti njihet me tiparet që nuk ndryshojnë nga njëri juridiksion në tjetrin. Në këtë mënyrë studenti fiton njohuri ndër-juridiksionale duke pasur mundësi të ndjekë, më pas, studimet në nivelin master, duke njohur tatimet/taksat sipas juridiksionit ku ai zhvillon masterin. Studenti i bachelorit fiton njohuri konceptuale, afatgjata dhe ta zbatuara kudo. Kjo i lë vend njohjes së taksimit në nivelin master me qëllim shmangien e riskut fiskal dhe rritjen e përputhshmërisë ligjore për njësinë ekonomike, pra legjislacionit tatimor.

Analiza teorike trajton arsyet për këtë ngjashmëri të detyrimit tatimor nga një juridiksion në tjetrin. Qasja ndaj parimeve (analiza normative) përbën arsyen kryesore për ngjashmëritë e detyrimit tatimor ndër juridiksione të ndryshme. Arsye të tjera për këtë përvijim tiparesh të ngjashme janë funksionalizimi dhe ekonomikiteti.

Libri i trajtuar është Taksimi Normativ. Në krerët e parë të këtij libri trajtohen argumenti teorik dhe tiparet e ngjashme të tatimit/taksës. Në krerët në vijim trajtohen detyrimet tatimore në Shqipëri në optikën e tipareve të identitetit.